



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT – RAPORT

PËR

AUDITIMIN ME BAZË SISTEMI

MBI

**“VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË, RREGULLSHMËRISË DHE
PERFORMANCËS SË REALIZUAR PREJ DREJTORISË JURIDIKE DHE
E BURIMEVE NJERËZORE, BASHKIA ROSKOVEC”.**

Periudha e audituar: 01.01.2017 deri 30.9.2020

Grupi i auditëve : Gëzim HABILI

Eltona ÇEPELE

Gilda Zyka

Roskovec, Dhjetor, 2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT RAPORT

***MBI ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË DREJTORINË JURIDIKE
DHE BURIMEVE NJERËZORE, PRANË BASHKISË ROSKOVEC.***

Mbahet sot më datë 15.12.2020 nga grupi i punës së audituesve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Roskovec, mbi angazhimin e auditimit për ***“Vlerësimin e veprimtarisë në zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe performancës së realizuar nga Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Roskovec”***.

Angazhimi i auditimit në këtë subjekt u mbështet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, si dhe programin e auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë.

I. Përmbledhje ekzekutive.

Sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë me shkresën nr. 5411, prot. datë 13.10.2020, ***“Mision angazhim auditimi për vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore”***, grupi i auditimit i përbërë nga Përgjegjës grupi z. Gëzim Habili, audituese zj. Gilda Zyka dhe audituese zj. Eltona Çepele, realizoi misionin e angazhimit të auditimit në Drejtorinë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Roskovec.

Qëllimi i këtij mision auditimi është që të ndihmojë Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Roskovec, në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e

kontrollit të brendshëm, nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënia e sigurisë objektive mbi dokumentimin e aktivitetit të të gjithë Sektorëve të saj, si dhe dhënia e rekomandimeve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për përmirësimin e punës në vazhdimësi, etj.

II. Hyrje

Gjatë kryerjes së misionit të auditimit, nga grupi i auditimit është synuar një vlerësim në tërësi i sistemeve në përputhje me Udhëzimet dhe metodikat e miratuara, me qëllim që sistemet e menaxhimit financiar e të kontrollit si dhe performanca e njësisë së audituar, të jenë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.

Auditimi është realizuar nga data 15.10.2020 deri 30.11.2020, gjithsej 32 (tridhjetë e dy) ditë pune, për periudhën e audituar nga **01.01.2017 deri 30.09.2020**.

Janë diskutuar në Takimin fillestar (të Hapjes) me Drejtoren e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore zj. Delina Hoxha, P/Sektorit të Burimeve Njerëzore zj. Olta Brahusi, P/Sektorit të Çështjeve Juridike zj. Drinalda Fejzulla, P/Sektorit të Protokoll Arkivit zj. Irena Gjata, si dhe me punonjës të tjerë të kësaj Drejtorie, objektivat, formatet, metodat e auditimit, linjat e komunikimit, si dhe afatet për raportime.

Gjatë këtij misioni auditimi janë realizuar të gjitha pikat e programit sipas tematikës së miratuar. Pasi ka përfunduar edhe puna në terren, janë diskutuar gjetjet (konstatimet) e këtij misioni auditimi me stafin e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec, dhe është rënë dakort për çështjet e dala.

III. Metoda e Auditimit.

Gjatë realizimit të misionit të auditimit, grupi i punës i auditimit ka punuar në përputhje me udhëzimet dhe metodikat e miratuara. Është mbuluar me auditim periudha **01.01.2017 deri 30.09.2020**. Audituesit janë njohur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe kanë bërë një vlerësim në tërësi të sistemeve. Komunikimi i qartë, konçiz dhe në kohë me stafin e njësisë së audituar ka ndihmuar në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të auditimit.

Auditimi u krye në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe të Urdhëri nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Në zbatim të programit të miratuar u audituan çështjet si më poshtë :

I. Auditimi i sistemeve të Proçeseve Organizative.

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore ;

Zbatimi i Strukturës Organizative, si dhe zbatimi i nivelit të pagave.

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Roskovec, e ushtron aktivitetin e saj në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ; Ligjin nr. 30/2015, "Për disa ndryshime e shtesa në “ Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar ; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar ; Ligjin nr. 152/2015, "Për Nëpunësin Civil" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij ; Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike” ; Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" ; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ; Ligjin nr. 7697 datë 07.04.1993 “Për kundravajtjet Administrative” ; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” ; VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, etj.

Misioni kryesor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore është sigurimi i zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e Këshillit Bashkiak, të Komisioneve të tij, të Titullarit (Kryetarit të Bashkisë) dhe administratës, nëpërmjet asistencës dhe konsulencës juridike, si dhe përputhshmërisë në fushat ku organet kolegjale dhe individuale të Bashkisë Roskovec, ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre, mbështetur në kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë.

Nga auditimi u konstatua se është hartuar **Rregullore e Brendshme** e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, në të cilën është shprehur *Baza Ligjore* ku mbështetet puna e kësaj Drejtorie, struktura organizative dhe funksionimi i saj. Për sa i përket kryerjes së detyrave, çdo nëpunës dhe punonjës i Drejtorisë ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë, për të cilat përgjigjet para niveleve më të larta.

Për periudhën e audituar nga 01.01.2017 – 30.09.2020 rezultoi se, për Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Roskovec, ishin marrë Vendimet e Kryetares së Bashkisë për strukturën organizative dhe nivelin e pagave si më poshtë :

Kryetare e Bashkisë për vitin 2017, ka miratuar Vendimin “Për Strukturën organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum” me nr.

12, datë 10.01.2017, ku për Drejtorinë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore ka miratuar 24 (njëzetë e katër) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie, ku për Sektorin e Shërbimeve Juridike 5 (pesë) punonjës, prej të cilëve 1 (një) Përgjegjës Sektori Juridik, 1 (një) Specialist Jurist, 1 (një) Specialist Informacioni dhe Promocioni, 1 (një) Specialist i Teknologjisë së Informacionit, 1 (një) Punonjës i Marrëdhënieve me Komunitetin. Në Sektorin e Arkivave të Dokumentacionit 5 (pesë) punonjës, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Arkivave të Dokumentacionit, 1 (një) Punonjës Protokoll - Arkivi në Bashkinë Roskovec, 1 (një) Punonjës Protokoll - Arkivi në Njësinë Administrative Kuman, 1 (një) Punonjës Protokoll - Arkivi në Njësinë Administrative Kurjan, 1 (një) Punonjës Protokoll - Arkivi në Njësinë Administrative Strum. Kurse në Sektorin e Burimeve Njerëzore 13 (trembëdhjetë) punonjës, 1 (një) Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Specialist i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Punonjës Mirëmbajtje të Rrjetit Teknik e Elektronik, 1 (një) Kameraman e Fotograf, 2 (dy) Shofer Administrate, 2 (dy) Pastrues Godine të Bashkisë Roskovec, 1 (një) Roje Godinat e Institucioneve (Bashkia + Pallati i Kulturës) Roskovec, 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Kuman, 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Kurjan, 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Strum.

Ndërsa për vitin 2018, në strukturë, Kryetare e Bashkisë ka miratuar Vendimin “Për Strukturën organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum” me nr. 15, datë 12.01.2018, ku për Drejtorinë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore ka miratuar 20 (njëzetë) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie. Për Sektorin Juridik dhe i Prokurimeve 6 (gjashtë) punonjës, 1 (një) Përgjegjës Sektori Juridik dhe i Prokurimeve, 1 (një) Specialist Jurist për Proçeset Gjyqësore, 1 (një) Specialist Jurist për Prokurimet, 1 (një) Specialist Inxhinier për Prokurimet, 2 (dy) Punonjës të Zyrës së Informacionit. Në Sektorin e Burimeve Njerëzore 13 (trembëdhjetë) Punonjës, 1 (një) Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Specialist i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Punonjës Mirëmbajtje të Rrjetit Teknik e Elektronik, 1 (një) Kameraman e Fotograf, 2 (dy) Shofer Administrate, 1 (një) Pastrues-Godina e Institucionit (Bashkina Roskovec), 1 (një) Pastrues - Godina e Institucionit (Pallati i Kulturës Roskovec), 1 (një) Roje Godina e Institucionit (Bashkia Roskovec), 1 (një) Roje Godina e Institucionit (Pallati i Kulturës Roskovec), 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Kuman, 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Kurjan, 1 (një) Pastrues + Roje Godina e Njesisë Administrative Strum.

-Për vitin 2019 ishte marrë Vendimi i Kryetares së Bashkisë nr. 473, datë 26.12.2018, “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë

Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum dhe Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2019”, , ku për Drejtorinë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore ka miratuar 10 (dhjetë) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie. Për Sektorin Çështjeve Juridike (3 punonjës), 1 (një) Përgjegjës Sektori, 2 (dy) Specialist, Në Sektorin e Burimeve Njerëzore (3 Punonjës), 1 (një) Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Specialist i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Punonjës i Zyrës së Informacionit, dhe në Sektorin e Protokoll-Arkivit 3 (tre) punonjës), 1 (një) Përgjegjës Sektori, 2 (dy) Specialistë.

-Për vitin 2020 është marrë Vendimi i Kryetares së Bashkisë nr. 168, datë 14.01.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum dhe Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2020”, ku për Drejtorinë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore ka miratuar 20 (njëzetë) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie, për Sektorin Çështjeve Juridike 3 (tre) punonjës, 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialistë, në Sektorin e Burimeve Njerëzore 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës, 1 (një) Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore, 1 (një) Specialist i Burimeve Njerëzore, 2 (dy) Punonjës të Zyrës së Informacionit, 8 (tetë) Roje + Pastrues Godina, si dhe 4 (katër) Punonjës të shërbimeve mbështetëse (Mirëmbajtjes i rrjetit elektronik, shofer, kameraman).

Nga verifikimi i **nivelet të pagave** (jo vetëm për punonjësit e kësaj strukture, por edhe për të gjithë punonjësit e tjerë) të përcaktuar në vendimet e mësipërme, konstatohet se janë respektuar përcaktimet e VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetqeverisjes vendore”. Nga sa më sipër, nuk rezultuan shkelje të dispozitave ligjore të sipërcilësuar.

Nga auditimi i dokumentacionit për strukturën organizative të Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Roskovec (por edhe për të gjithë personelin punonjës të Bashkisë), rezulton se është operuar me struktura të miratuara nga Kryetare e Bashkisë me Vendimet përkatëse për çdo vit të audituar. Për të gjithë punonjësit e këtij Institucioni janë hapur dosjet e personelit si dhe janë lidhur kontratat individuale sipas Ligjit nr. 7961, datë 17.01.1995 “Kodi i Punës në RSH” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" të ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

Po këtu, evidentohet se, për periudhën objekt auditimi është operuar me strukturë të paplotësuar.

Si pjesë e strukturës organizative të kësaj Drejtorie janë edhe 2 (dy) drejtuesit e automjeteve të Administratës, për të cilat gjatë këtij misioni u audituan edhe *shpenzimet për transport*.

Për auditimin e këtyre shpenzimeve për të gjithë periudhën Janar 2017 – Shtator 2020, u përqëndruam në kqyrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm si : Urdhër Shpenzimet (për blerjen e karburantit dhe kryerjen e shërbimeve) për automjetet që ka në varësi kjo Drejtori, si dhe Fletë - Hyrjet e Fletë - Daljet e magazinës, e tj.

Në këtë mision angazhim auditimi konstatohet se, lëvizjet e automjeteve, evidentimit të tyre në Fletët e udhëtimit, nënshkrimin të drejtuesve të automjeteve, nxjerrja e Urdhërave të Titullarit për ngritjen e Komisioneve të përlogaritjeve të normativave të harxhimit të karburantit (respektivisht nr. 46, datë 27.01.2017, nr. 51, datë 29.01.2018, nr. 55, datë 30.01.2019 dhe nr. 197, datë 05.05.2020), të shoqëruara me proces verbalet përkatëse për çdo vit (datë 31.01.2017, 01.02.2018, 03.02.2019 dhe 07.05.2020). Inventari i mjeteve të transportit që kjo Drejtori ka në varësi, përbëhet nga automjeti Tip “Touareg” me targa AA 777 CV dhe automjeti Tip “Mercedez Benz” me targa AA 100 OC. Gjatë këtij auditimi (për të gjithë periudhën 01.01.2017 – 30.09.2020) nuk konstatohen të meta e parregullsi në përlogaritjen e karburantit të harxhuar (për lëvizje të automjeteve).

Për sa më sipër, për këtë periudhë rezulton se, shpenzimet për karburant e pjesë këmbimi, ndonëse zënë një peshë specifike deri diku të konsiderueshme të shpenzimeve operative, ato janë brenda limiteve të përcaktuara dhe të planifikuara me Vendime të Këshillit Bashkiak.

II. Sistemi i evidentimit të veprimtarisë së Sektorit të Çështjeve Juridike.

Nga ky auditim konstatohet se, për :

-Shqyrtimin juridik të Projekt – Vendimeve të hartuara gjatë periudhës objekt auditimi nga 1 Janar 2017 deri 30 Shtator 2020 rezultoi :

Vendime të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2017 gjithsej 78 (shtatëdhjetë e tetë) ;

Vendime të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2018 gjithsej 107 (njëqind e shtatë) ;

Vendime të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2019 gjithsej 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) ;

Vendime të Këshillit Bashkiak Roskovec për periudhën Janar - Shtator 2020 gjithsej 78 (shtatëdhjetë e tetë).

Po kështu, nga kqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga kjo Drejtori, në lidhje me aktet e nxjerra nga Titullari, rezultoi se :

Gjatë vitit 2017 kanë dalë nga Titullari 313 (treqind e trembëdhjetë) Urdhëra + Vendime ;

Gjatë vitit 2018 kanë dalë nga Titullari 471 (katërqind e shtatëdhjetë e një) Urdhëra + Vendime.

Gjatë vitit 2019 kanë dalë nga Titullari 102 (njëqind e dy) Urdhëra + Vendime, si dhe janë hartuar 18 (tetëmbëdhjetë) Projekt - Vendime, janë lidhur 5 (pesë) kontrata dhe marrëveshje.

Gjatë periudhës Janar - Shtator 2020 kanë dalë 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë) Urdhëra të Brendshëm nga Titullari. Po kështu, gjatë kësaj periudhe janë lidhur 58 (pesëdhjetë e tetë) kontrata dhe marrëveshje.

Për sa i përket përfaqësimit të Institucionit të Bashkisë Roskovec në organet e pushtetit gjyqësor përgjatë gjithë periudhës së audituar, të dhëna më të detajuara i gjeni në pasqyrën e mëposhtme :

Nr.	Lloji i Çështjeve Gjyqësore	Pozicioni i Bashkisë	Objekti i Çështjes	Statusi i Çështjes	Vendim	
					Në proces	Ankimuar
1.	Çështje civile	Paditës	Kostatim i pavlefshmërisë absolute pjesërisht	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	
2.	Çështje administrative	Ankimues	Kundërshtim i veprimeve përmbartimore	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	
3.	Çështje administrative	Palë e tretë	Deklarim i pavlefshmërisë së pjesshme të AMTP-së	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Rrëzuar	
4.	Çështje civile	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e rrethit gjyqësor Fier	Fituar nga Bashkia	
5.	Çështje civile	Palë e paditur	Pavlefshmërisë absolute e aktit administrative, nr. 1, datë 10.10.2018 Për prishjen e objektit të kundraligjshëm	Gjykata ad. E shkallës parë Vlorë rrëzuar	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë

6.	Çështje civile	Palë e paditur	Heqje e zotësisë për të vepruar	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	
7.	Çështje civile	Palë e paditur	Detyrim për derdhje ujrash, shpërblim dëmi etj.	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	
8.	Çështje civile	Palë e tretë	Lëshim urdhër mbrojtje	Gjykata e shkallës parë Fier	Jo	Jo
9.	Çështje civile	Paditës	Ndryshimin e VKM nr. 19. Për shpronësimin, për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga projekti "Rikualifikimi urban i bllokut nr. 2, i qytetit të Roskovecit"	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Rrëzuar	
10.	Çështje administrative	Ankimues	Zgjidhje kontratë qiraje	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Nuk ka ankim
11.	Çështje civile	Palë e tretë	Marrjen e masës së gjobës ndaj Majlinda Bufit në favor të kreditorit Irvan Toro	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pranuar pjesërisht nga Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë më datë 09.10.2017	
12.	Çështje administrative	Kallzues	Shpërdorim detyre	Për hetim në Prokurinë e Rrethit Gjyqësor Fier	Pushim gjykimi	
13.	Çështje civile	Paditës	Korigjimi i emrave	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Në pritje	
14.	Çështje civile	Palë e paditur	Zgjidhje kontratë qiraje	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Fituar nga Bashkia	
15.	Çështje civile	Palë e tretë	Marrjen e masës së gjobës	Gjykata ad. e shkallës parë	Gjykata ad. e shkallës parë	

			ndaj Majlinda Bufit në favor të kreditorit Mestan Alushaj	Vlorë	Vlorë me vendim nr. 1066 datë 11.05.2016 Vlorë ka bërë shlyerjen e detyrimit	
16.	Çështje civile	Palë e tretë	Vërtetim fakti të qënies në marrëdhënie pune	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	
17.	Çështje administrative	Palë e paditur	Regjistrim prone	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
18.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
19.	Çështje civile	Palë e tretë	Vërtetim fakti	Gjykata Apelit Vlorë	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
20.	Çështje administrative	Palë paditëse	Konstatim i pavlefshmërisë absolute	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
21.	Çështje administrative	Palë paditëse	Konstatim i pavlefshmërisë relative	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
22.	Çështje civile	Palë e paditur	Njohje pronar	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
23.	Çështje civile	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
24.	Çështje civile	Palë e paditur	Përcaktim kufijsh	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
25.	Çështje civile	Palë e paditur	Vërtetim fakti, njohje pronar	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	Në Gjykatën e lartë

						Tiranë
26.	Çështje civile	Palë e paditur	Konstatim i pavlefshmërisë relative	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
27.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshimi i masës së shpërblimit	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
28.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
29.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	
30.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
31.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
32.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizim i pjesshëm i aktit administrativ nr. 17	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
33.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të shoqërisë përmbarimore "Prestige Bailife Services" sh.p.k	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë vendim i dates 09.10.2017
34.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të shoqërisë përmbarimore "Prestige Bailife Services" sh.p.k	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
35.	Çështje civile	Palë e paditur	Detyrimin e të paditurit për të paguar	Gjykata e shkallës parë Fier	Gjykata e shkallës parë Fier ve	

			detyrimin e pa shlyer		vendim 2211 datë 07.12.2018 pranimin pjesërisht të kërkespadiisë	
36.	Çështje administrative	Palë paditëse	Pavleshmëri e titujve ekzekutivë, fatura të energjisë elektrike	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
37.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi nr. 3282/3 datë 29.07.2020	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	
38.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të Shoqërisë përmbarimore "Prestige Bailife Services" sh.p.k	Gjykata ad. Apelit Tiranë vendimi nr. 129 regj	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
39.	Çështje civile	Paditës	Zgjidhje kontrate qiraje	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë me vendim 1050 datë 17.09.2018 pranuar pjesërisht	Nuk ka ankim
40.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Fituar Bashkia	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
41.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Pranimin e padisë	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
42.	Çështje administrative	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të shoqëria përmbarimore "Prestige	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë

			Bailife Services” sh.p.k për kreditoren Bajame Manaj			
43.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarimore të shoqëria përmbarimore “Prestige Bailife Services” sh.p.k për kreditoren Viktori Kothere	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
44.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
45.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
46.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
47.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
48.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi nr. 4	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykata e lartë Tiranë
49.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi nr. 148	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykata e lartë Tiranë
50.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarusit gjyqësor privat z. Neritan Çuko për shumën 50.000 lekë	Gjykata e lartë Tiranë vendimi nr. 136 (62-2017-554) datë 10.02.2017 Gjykatës Fier	Po	Në Gjykata e lartë Tiranë vendim nr. 132
51.	Çështje civile	Palë e	Kundërshtim i	Gjykata e	Po	Në

		tretë	veprimeve përmbarsit gjyqësor privat z. Neritan Çuko për shumën 50.000 lekë	lartë Tiranë vendimi nr. 62-2017-2454(723) 62-2017		Gjykata e lartë Tiranë vendim nr. 723
52.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përmbarsit gjyqësor privat z. Neritan Çuko për shumën 50.000 lekë	Gjykata e lartë Tiranë vendimi date 25.05.2017	Po	Në Gjykata e lartë Tiranë vendim date 25.05.2017
53.	Çështje civile	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
54.	Çështje civile	Palë e paditur	Detyrimin e pales së paditur për të më paguar shpërblimin për dëmin që më ka shkaktuar në bazë të nenit 608e vijues të kodit civil	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
55.	Çështje civile	Palë e tretë	Lirim,dorëzim sendi	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
56.	Çështje civile	Palë e tretë	Njohje pronar	Gjykata e rrethit gjyqësor Fier	Gjykata e rrethit gjyqësor Fier me vendim 503 datë 12.04.2018 Pushim çështje	Nuk ka ankim
57.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi nr. 32	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
58.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë

						Tiranë
59.	Çështje civile	Palë e paditur	Lirim,dorëzim i fushës së sportit	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
60.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshim i pjeshëm i VKM nr. 19 datë 16.01.2019 “për shpronësim për interes publik”	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
61.	Çështje civile	Palë e paditur	Shpërblim dëmi	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	
62.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshim i pjeshëm i VKM nr. 19 datë 16.01.2019 “për shpronësim për interes publik”	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
63.	Çështje civile	Palë e tretë	Detyrimin e të paditurve të plotsojnë aktin e marrjes së tokës në pronësi datë 24.02.1994 dhe të trajtojnë paditësat edhe me 4900 m ² tokë bujqësore shtesë sipas normës për frymë në fshatin Marinëz	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pranuar	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
64.	Çështje administrative	Palë e paditur	Anullim i pjeshëm i VKM nr. 19 datë 16.01.2019 “për shpronësim për interes publik”	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
65.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizim akti administrative	Gjykata ad. e shkallës parë	Po	Në Gjykatën

				Vlorë		ad. Apelit Tiranë
66.	Çështje penale	Palë e paditur	Shkatërim i rrjetit të ujësjellësit	Gjykata e shkallës parë Fier	Fituar Bashkia	
67.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizimin për pjesën e shpronësimit të paditësve të miratuar me vendimin nr. 705 datë 30.10.2019 për disa ndryshime dhe shtesë në vendimin nr. 19 datë 16.01.2019 të këshillit të Ministrave	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pezulluar për 6 muaj	
68.	Çështje administrative	Palë e tretë	Kundërshtim i vendimit nr. 7 datë 21.05.2018 Palë e tretë ISHMP Fier	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Me vendim nr. 265 datë 27.02.2019 rrëzimin e kërkesë padisë	
69.	Çështje civile	Palë e tretë	Deklarimin e pavlefshmërisë së pjeshme të aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr.12624 datë 21.09.1993 të familjes bujqësore Llaqi Pipa për një sip. 840 m2	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pranuar	
70.	Çështje civile	Palë e tretë	Njohje pronar	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
71.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshim vendimi të këshillit të Ministrave nr. 19 datë	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Ankim në Gjykatën ad. Apelit Tiranë

			16.01.2019 për sa i përket masës së shpërblimit të paditësit Arshi Buzi			
72.	Çështje civile	Palë e tretë	Pavlefshmëri Të pjeshme të AMTP-së shfuqizim akti nr. 6510	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pranuar	
73.	Çështje civile	Palë e paditur	Lirim dhe dorëzim sendi, shpërblim sendi	Gjykata e shkallës parë Fier	Kthimin e padisë për mos plotësim të dhënash	Jo
74.	Çështje civile	Palë e paditur	Pavlefshmëri absolute e veprimit juridik të nënshkrimit të akt-marrëveshjes për pagesën e kompesimit të dëmeve midis Pavli Mara dhe Bankers Petroleum si të pa bazuar në dokumenta hipotekore, detyrimi i Bankers Petroleum të bëjë një marrëveshje të re me pronare Jorgjie Dore dhe Pavli Mara për pagesën e kompesimit të dëmeve	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Moskopotente	
75.	Çështje civile	Palë e paditur	Detyrimin e Bashkisë për mospagimin e vazhdimin të punimeve të	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë

			ndërtimit			
76.	Çështje civile	Palë e paditur	Pushim cënimi pronësie	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
77.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi për lirim nga shërbimi civil. Detyrim i palëssë paditur për ta rikthyer në pozicionin e punës, për ti paguar pagën që do të përfitonte nga moment i largimit deri në momentin e ripranimit, për të dëmshpërblyer për lirim nga shërbimi civil në përputhje me vjetërsinë në punë	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
78.	Çështje administrative	Palë e tretë	Marrje e masës së gjobës	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë
79.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim njoftimi për arkëtim te detyrimit tatimor 2347 prot, për ndotje ambjenti	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
80.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 19 datë 16.01.2019 të Këshillit të Ministrave.	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
81.	Çështje civile	Palë e	Shfuqizimin e	Gjykata ad. e	Fituar nga	

		paditur	njoftimit për arkëtim të detyrimit tatimor nr. 2347 prot, date 09.05.2019	shkallës parë Vlorë	pala paditëse	
82.	Çështje civile	Palë e paditur	Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 19 datë 16.01.2019 të këshillit të ministrave.	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
83.	Çështje civile	Palë e paditur	Anullimin e aktit nr. 7104 prot, datë 05.12.2019, njoftim për shlyerje detyrimesh	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	
84.	Çështje civile	Palë e paditur	Anullim i pjesshëm i VKM 705 datë 30.10.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM ne. 19 datë 16.01.2019	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Pezulluar për 6 muaj	
85.	Çështje penale	Palë e paditëse	Revokim gjobe ndaj Kryetares së Bashkisë	Gjykata e shkallës parë Fier	Në Gjykatën e shkallës parë Fier	
86.	Çështje administrative	Palë e paditur	Ndryshimin e VKM nr. 19, datë 16.01.2019 për shpronësimin e truallit me sip. 2188 m ²	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
87.	Çështje administrative	Palë e paditur	Njohje pronar	Gjykata e shkallës parë Fier	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
88.	Çështje administrative	Palë e paditur	Marrjen e masës së sigurimit dhe shpalljen si të paligjshme të	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë

			njoftimit nr. 3846 prot, datë 02.10.2018.			
89.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizimin e njoftimit per arketim te detyrimit tatimr nr.2819 prot, datë 17.05.2019	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
90.	Çështje administrative	Palë e paditur	Detyrimin e pales se paditur te bejë verifikimin e vlefshmërisë ligjore të ATMP me nr akti 13139, datë 24.01.1994	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Ankim në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
91.	Çështje administrative	Palë e paditur	Shfuqizimin e aktit administrativ vendim për prishje e objektit të kundërligjshëm nr.13 datë 10.10. 2018 të IVMT Bashkia Roskovec	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Ankim në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
92.	Çështje administrative	Palë e paditur	Anullimin e pjesëshëm të vendimit nr. 19, datë 16.01.2019 për shpronësim për interes publik.	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
93.	Çështje civile	Palë e tretë	Lirim dorëzim toke	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	
94.	Çështje civile	Palë e paditur	Detyrim dëmshpërblimi per sip 65 m2 me vlerën reale, kompesim per zhvleftësimin e pjesës së mbetur të	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë

			pronës.			
95.	Çështje civile	Palë e paditur	Njohjen e pavërtesisë së dokumentit akt i marrjes së tokës në pronësi	Gjykata e shkallës parë Fier	Vendimi nr. 1028 datë 13.07.2017 pranimin e padisë	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
96.	Çështje civile	Palë e tretë	Kundërshtim i veprimeve përbarimore të zyrës përbarimore “Best 2010” sh.p.k për Urdhërin me nr. 101/19 prot, datë 03.01.2018	Gjykata e Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
97.	Çështje civile	Palë e tretë	Lirim dorëzim toke	Gjykata e Apelit Vlorë	Fituar	Jo
98.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim vendimi	Gjykata e Apelit Tiranë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
99.	Çështje administrative	Palë e paditur	Dëmshpërblim, pagim page	Gjykata ad. e shkallës parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
100.	Çështje administrative	Palë e tretë	Konstatim i pavlefshmërisë absolute	Gjykata e Apelit Tiranë	Po	
101.	Çështje civile	Palë e paditur	Shfuqizim i pjeshëm i vendimit nr. 40 për tarifën e ndotjes dhe shfuqizim vendimi nr. 70 për tarifën e pastrimit	Gjykata ad. Apelit Tiranë	Rrëzuar	Jo
102.	Çështje civile	Paditës	Kundërshtim i veprimeve përbarimore të Zyrës përbarimore “Best 2010” për vendimin me	Gjykata e lartë Tiranë	Po	Në Gjykatën e lartë Tiranë

			nr. 101/20 prot, datë 11.02.2018			
103.	Çështje civile	Palë e tretë	Vendosje kujdestarie	Gjykata e Apelit Vlorë	Po	
104.	Çështje civile	Palë e tretë	Konstatim i pavlefshmërisë absolute të aktit administrative vendim nr. 04 datë. 10.10.2018 të I.V.M.T	Gjykata Administrative e shkallës së parë Vlorë	Po	Në Gjykatën ad. Apelit Tiranë
105.	Çështje civile	Palë paditëse	Kundërshtim i vendimit të përmbauesit gjyqësor privat, z. Engjëll Muskaj për shumën 50.000 lekë	Gjykata e shkallës parë Fier	Rrëzuar në Gjykatën e shkallës parë Fier vendim nr. 638, datë 15.05.2017	Në Gjykatën e Apelit Vlorë
106.	Çështje civile	Paditës	Kundërshtim i vendimit të përmbauesit privat z. Neritan Cuko për shumën 30.000 lekë	Gjykata e Apelit Vlorë	Me vendim nr. 117 datë 20.07.2017 Rrëzuar ankimimi	Në Gjykatën e lartë Tiranë

Për sa i përket shqyrtimit juridik dhe sigurimit të asistencës ligjore mbi çështjet dhe problematikat e ndryshme që kërkohen për t'u trajtuar, në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të të gjitha strukturave të Bashkisë, konstatohet se përgjithësisht kjo strukturë ka qënë e gatëshme dhe e pranishme.

III. Sistemi i evidentimit të veprimtarisë së Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Gjatë këtij misioni auditimi, në evidentimin e veprimtarisë së Sektorit të Burimeve Njerëzore, konstatohet se :

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 64, germa j, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, neni 18 dhe 19, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pika 11, të Vendimeve të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Roskovec (për vitet 2017, 2018, 2019 e 2020)”, të konfirmuara nga

-Gjatë vitit 2019 janë kryer 50 (pesëdhjetë) trajnime e kurse ;

-Gjatë periudhës Janar - Shtator 2020 janë kryer 29 (njëzet e nëntë) trajnime.

- Nga kqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ky Sektor, në lidhje me Masat Administrative të dhëna për punonjësit e Bashkisë për të gjithë periudhën e audituar Janar 2017 – Shtator 2020, rezultoi se (të dhëna më të plota për këtë rubrikë, i gjeni në pasqyrën si më poshtë) :

Nr.	Emërtimi i Masës Administrative	Viti				Totali
		2017	2018	2019	2020	
1	Vërejtje	21	32	26	13	92
2	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	2	-	-	-	2
3	Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate	2	-	1	-	3
4	Largim nga shërbimi civil	2	-	-	-	2
6	Tërheqje vëmendje	-	-	-	1	1
7	Vërejtje me paralajmërim	-	-	-	1	1
	SHUMA	27	32	27	15	101

Vendimet për dhënien e masës disiplinore janë:

- Për thyerje të etikës dhe disiplinës në punë ;
- Për mospërbushje të rregullt të detyrës ;
- Për moszbatim të urdhërit të përgjegjësit përkatës dhe mospërbushje të rregullt të detyrës ;
- Për thyerje të disiplinës në punë, konkretisht për mosparaqitjen në vendin e punës brënda orarit zyrtar ;
- Për mosmbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ;
- Për largim nga vendi i punës pa arsye dhe pa njoftim sipas raportit bashkëngjitur të përgjegjësit përkatës ;
- Për thyerje të kushteve të kontratës ;
- Për thyerje të urdhërit të eprorit (të Kryetares së Bashkisë) ;
- Për shkak të shkeljes shumë të rëndë, mospërbushjes së plotë të detyrave ;
- Për shkak të braktisjes së vendit të punës për më shumë se 7(shtatë) ditë, ku mungesa e tij ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të Institucionit ;

Kreut II e III, të VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar me VKM nr. 748, datë 19.02.2018, Institucioni i Bashkisë Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë. Bazuar në VKM nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurën e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorive ekzekutive të ulët dhe të mesme drejtuese”, mbahet proces verbal mbi realizimin e kësaj procedure për *pozicionin e ulët drejtues* (me apo pa konkurentë), mbi bazën e të cilit njoftohen kandidatët e kualifikuar për fazën e verifikimit paraprak. Më tej, njoftohet Shërbimi Kombëtar i Punësimit për publikim të listës së kandidatëve të kualifikuar.

Në zbatim të neneve 25 e 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, dhe të Kreut III të VKM nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësat civilë të kategorive ekzekutive, të ulëta dhe të mesme drejtuese”, me Urdhër të Titullarit ngrihet (krijohet) **Komisioni i Ngritjes në Detyrë** me përbërje të specialistëve të fushës për pozicionet përkatëse, për të vazhduar me fazën e dytë të vlerësimit. Nga ana e tyre, të gjithë anëtarët e këtij Komisioni deklarojnë për paanshmëri në vlerësim, pasi kanë përgatitur tezën e testimit me shkrim dhe listën e pyetjeve të intervistës së strukturuar. Mbas përfundimit të procedurës së testimit të ngritjes në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese në shërbimin civil, ky Komision harton Raportin e renditjes (klasifikimit) të kandidatëve fitues dhe i dërgon Listën emërore të fituesve Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Edhe për vitet në vijim, është respektuar e njëjta procedurë e përshkruar sa më sipër.

- Për sa i përket krijimit të kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale të punonjësve të Bashkisë Roskovec, konstatohet që nëpërmjet trajnimeve dhe kurseve të organizuara nga organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, bazuar në ftesat e tyre, pjesëmarrja (përfaqësimi) i Institucionit tonë në këto trajnime ka qënë përherë e pranishme, kjo si pasojë e rritjes së interesit të shprehur nga Bashkia jonë për t’u përfaqësuar në to (minimalisht me një punonjës). Tematikat e trajtuara në këto kurse e trajnime kanë qënë sa të ndryshme, aq dhe të larmishme, për t’i shërbyer mënyrës së funksionimit të të gjitha strukturave të Bashkisë.

Në të gjithë periudhën e audituar, rezultoi që :

-Gjatë vitit 2017 janë kryer 37 (tridhjetë e shtatë) trajnime ;

-Gjatë vitit 2018 janë kryer 20 (njëzet) trajnime ;

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, të Vendimeve të Kryetares së Bashkisë (respektivisht nr. 12, datë 10.01.2017, nr. 15, datë 12.01.2018, nr. 473, datë 26.12.2018 dhe nr. 168, datë 14.01.2020) “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum për vitet 2017 e 2018” dhe “..... dhe të Ndërmarrjeve në varësi të saj për vitet 2019 e 2020”, janë hartuar Raportet për vendet e lira (vakante) që ekzistojnë në strukturën organizative të Institucionit të Bashkisë (për të gjithë periudhën objekt auditimi), edhe për pozicione në shërbimin civil sipas legjislacionit përkatës, për të cilat duhet të kryhen procedurat përkatëse për plotësimin e tyre/rekrutim në shërbimin civil.

Bazuar nga sa më sipër, me Urdhër të Brendshëm të Titullarit për çdo vit të audituar është ngritur **Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, e cila nga ana e saj ka përvitësuar korrespondencën me Shërbimin Kombëtar të punësimit për publikimin e Shpalljeve për vende të lira pune në Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative të saj.

Duke vazhduar më tej, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, neni 22, si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategoritë ekzekutive”, është proceduar për grupin e pozicioneve të lira me apo pa konkurrencë të kandidatëve pjesëmarrës në fazën e parë, për të cilat vijohet me Njoftimin e verifikimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar për këtë faze. Po kështu, në zbatim të neneve 22 e 25 të Ligjit të cilësuar më sipër, të Kreut II, III, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, si dhe të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, Bashkia Roskovec ka shpallur (për çdo vit) procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve të vendeve vakante.

Për çdo grup të pozicioneve, me Urdhër të Titullarit janë ngritur (krijuar) Komitetet e Përhershme të Pranimin në Kategorinë Ekzekutive, me specialistë të fushave për këto grupe pozicionesh, të cilët marrin në testim (me shkrim e me gojë) kandidatët pjesëmarrës, dhe duke përfunduar me komunikimin e shpalljes fitues ose jo të këtyre kandidatëve.

Edhe për vitet në vijim, është respektuar e njëjta procedurë e përshkruar sa më sipër.

Në lidhje me procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, do të konstatohet se :

Mbas njoftimit të Shërbimin Kombëtar të Punësimit për **publikim** të Shpalljes të vendit të lire të punës, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, nenet 25 e 26, si dhe të

- Për mosdhënien në kohë të informacionit të kërkuar nga Ministria e Brendëshme, brënda afatit të caktuar ;
- Për shkak të cënimit të vijueshmërisë së punës në zyrën e Gjendjes Civile Kurjan ;
- Për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuale të një punëmarrësi në Administratën Publike.

- Në respektim të Vendimeve të Titullarit për strukturën organizative të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative të saj, për të gjithë periudhën e audituar konstatohet se është operuar me struktura të miratuara. Të dhëna më të plota për statusin që gëzojnë të gjithë punonjësit (Nëpunës në shërbimin civil, të konfirmuar, në periudhë prove, dhe me kontratë), i gjeni në tabelën si më poshtë :

Nr.	Emërtimi	Me status		Me kontratë Pune
		Të konfirmuar	Në periudhë prove	
1.	Viti 2018	18	17	133
2.	Viti 2019	25	22	133
3.	Janar - Shtator 2020	25	10	131

Nga sa më sipër, për vitin 2017 nga Sektori i Burimeve Njerëzore nuk na u vu në dispozicion dokumentacion për këtë qëllim, kurse për vitet e mëpasme pranë Bashkisë Roskovec janë punësuar në total, për vitin 2018, 168 punonjës, për vitin 2019, 180 punonjës, si dhe për periudhën Janar-Shtator 2020, janë punësuar 166 punonjës. Në tërësinë e dokumentacionit që kërkohet për plotësimin e dosjes së nëpunësit/punonjësit, përmendim :

1. Fotokopje e kartës së identitetit ;
2. Çertifikatë e Gjendjes familjare ;
3. Librezë pune ;
4. Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë + listë notash të noterizuara ose të shkollës së mesme ;
5. Çertifikatë ose diplomë e kualifikimeve ose të specializimeve (nëse ka) ;
6. Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka) ;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) ;
8. Vërtetim nga prokuroria e Rrethit Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ;
9. Raport mjekësor ;

10. CV ;
11. Vërtetim banke për numër llogarie ;
12. Vërtetim për shlyerjen e taksave.

- Për sa i përket **evidentimit** të kërkesave për punë në Institucionin tone, rezulton :

Punëkërkues në Bashkinë Roskovec :

- Në vitin 2017, 13 (trembëdhjetë) punëkërkues ;
- Në vitin 2018, 20 (njëzet) punëkërkues ;
- Në vitin 2019, 19 (nëntëmbëdhjetë) punëkërkues ,
- Në vitin 2020 (Janar-Shtator), 13 (trembëdhjetë) punëkërkues.

Nga ky auditim (për gjatë gjithë periudhës) konstatohet se, një masë e konsiderueshme e këtyre punëkërkuesve e kanë gjetur vehten si pjesë e Administratës së Bashkisë, apo ndërmarrjeve në varësi të saj.

IV. Sistemi i evidentimit të veprimtarisë së Sektorit të Protokoll Arkivës.

Në auditimin e veprimtarisë së Sektorit të Protokoll Arkivës, ndeshëm në faktin se kjo strukturë herë ka qënë pjesë e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore (vitet 2017 e 2019), dhe herë si strukturë më vehte (vitet 2018 e 2020). Në këtë kuadër (për të mos e audituar si strukturë më vehte), e përfshijmë në këtë mision angazhim auditimi, nga i cili konstatohet se i gjithë aktiviteti i këtij Sektori në tërësinë e funksionimit të tij, konsiston në :

- rregjistrimi në protokoll i të gjitha akteve administrative, arkivimi, administrimi, ruajtja dhe përpunimi i tyre, por edhe dorëzimi pranë organeve kompetente ;

- protokollimi i shkresave Hyrëse (nga Institucione të ndryshme, qytetarët, marrëveshje bashkëpunimi, etj. ;

- protokollimi i shkresave Dalëse (kthim përgjigje të ndryshme, vërtetime të ndryshme, autorizime për punonjësit dhe qytetarët, të hartuara nga Drejtori dhe Sektorë të Bashkisë ;

- protokollimi i të gjithë Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetares së Bashkisë ;

- përpunimi dhe sistemimi i dosjeve sipas përkatësisë të strukturave përbërëse administrative të Bashkisë, e tj. ;

Pasqyrim të plotë të kësaj veprimtarie e gjeni në tabelën e mëposhtëme :

Nr.	EMËRTIMI	Vendime	Urdhëra	Kthim përgjigje	TOTALI
1	Viti 2017	78	313	5096	5487
2	Viti 2018	107	471	6349	6927
3	Viti 2019	117	393	7565	8075
4	Janar - Shtator 2020	78	359	4675	5112
	SHUMA	380	1536	23685	20489

Në lidhje me përpunimin, sistemimin dhe dorëzimin të dokumentacionit pranë Arkivës Vendore Lushnje, rezulton se :

- ❖ Për ish Komunën Strum, është dorëzuar dokumentacioni i përfunduar për periudhën 1993-1999, në proces për t'u dorëzuar janë vitet 2000-2001 (janë të përpunuara) ;
- ❖ Për ish Komunën Kuman, është përpunuar dokumentacioni për periudhën 1996-1999 (janë në proces dorëzimi) ;
- ❖ Për ish Komunën Kurjan është dorëzuar dokumentacioni për vitin 1993, janë përpunuar dhe janë në proces dorëzimi vitet 1994-1995, dhe është duke u përpunuar dokumentacioni për periudhën 1996-1999 ;
- ❖ Për Bashkinë Roskovec është dorëzuar dokumentacioni për vitin 1995, është përpunuar dhe është në proces dorëzimi periudha 1996-1998, si dhe është duke u përpunuar dokumentacioni për vitin 1999.

Në përfundim të këtij auditimi, duke vlerësuar në tëresi (mbi bazën e kqyrjes me zgjedhje të dokumentacionit të vënë në dispozicion), për veprimtarinë e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, **konkludojmë** edhe që :

- Vlerësohet prania dhe gadishmëria jo vetëm e Drejtuesve por dhe e specialistëve të kësaj Drejtorie, në mbështetjen dhe sigurimin e asistencës ligjore mbi çështjet dhe problematikat që kërkohen për t'u trajtuar në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të të gjitha strukturave të Bashkisë (në pjesën më të madhe të tyre) të realizuara në periudhën objekt auditimi ;

- Vlerësohet frekuenca e shpejtë e përgjigjeve të adresuara jo vetëm për Institucionet sipërore, por sidomos korrespondenca (realizuar nga Sektori i Protokoll Arkivës) me komunitetin banues, brenda territorit të Bashkisë Roskovec (për të gjitha problematikat që trajtohen në kërkesë - ankesat e tyre), etj.

V. Plan Veprimi.

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 21, pika 7, të konkluzioneve të auditimit të plotë me bazë sistemi të ushtruar në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Roskovec për periudhën nga 01.01.2017 deri 30.09.2020, grupi i punës së auditëve

Rekomandon :

1. Të vazhdojë mbështetja dhe sigurimi i asistencës ligjore dhe juridike mbi çështjet dhe problematikat që kërkohen për t’u trajtuar, në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të të gjitha strukturave të Bashkisë Roskovec.

2. Të synohet që përfaqësimi në të gjitha konfliktet gjyqësore në të cilat Bashkia është palë ndërgjyqësore (për të gjitha shkallët e gjykimit), me qëllim që ky përfaqësim të jetë sa më dinjitoz nga ana e Bashkisë Roskovec për përftimin e interesave maksimale për Institucionin, por edhe për të siguruar gjithmonë mbrojtjen e interesave dhe pronës publike.

3. Të synohet që në hartimin e kontratave/marrëveshjeve/memorandumeve që Bashkia Roskovec lidh me subjekte të ndryshme juridike e fizike, vendase e të huaja, të arrihet përmirësimi dhe standartizimi i tyre në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, si dhe të akteve ligjore e nënljore që janë në fuqi.

4. Të vazhdojë zbatimi dhe respektimi i legjislacionit në fuqi për çdo procedure administrative që ndiqet nga Institucioni i Bashkisë Roskovec.

5. Të synohet që menaxhimi i burimeve njerëzore të realizohet me metoda e metodika bashkëkohore, duke u orientuar tek synimi për të patur një personel të trajnuar, të motivuar e me performancë të lartë në zbatim të Ligjit “Për Nëpunësin Civil”, të “Kodit të Punës në RSH”, akteve ligjore e nënljore në zbatim të tyre, si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Për sa më sipër, hartohet ky Projekt Raport Auditimi në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Roskovec, dhe mbas nënshkrimit si më poshtë, 1 (një) kopje i dorëzohet grupit të auditimit.

D/DREJTORISË JURIDIKE DHE B. NJERËZORE

Delina HOXHA



P/SEKTORIT TË ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Drinalda FEJZULLA




P/SEKTORIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Olta BRAHUSHI



P/SEKTORIT TË PROTOKOLL ARKIVËS

Irena GJATA



A u d i t u e s i t

Gëzim HABILI



Gilda ZYKA



Eltona ÇEPELE

